



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1181 Prot.

Tiranë, më datë 29.07.2021

VENDIM
Nr. 470, datë 28.07.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 28.07.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Rikonstrukcion banese”, brenda kufirit të Zonës së Mbrojtur të Qendrës Historike të qytetit të Gjirokastrës, me aplikues dhe projektues restaurator Jorgo Xuhano, zhvillues Andri Ibrahimaj;
2. Subjekti duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 619, datë 07.07.2015 “Për shpalljen e Qendrës Historike të një zone në qytetin e Gjirokastrës dhe miratimin e Rregullores “Për Mbrojtjen, Konservimin e Integruar Dhe Administrimin e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur në Qytetin e Gjirokastrës”, Shkodër e të Zonës së Mbrojtur përreth të saj dhe miratimin e Rregullores për Administrimin e saj”, Neni 15, Pika 4:
 - Zbatimi i punimeve të kryhet nga subjekte të licencuara për këtë kategori punimesh në ndërtim;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

